

Finca Kosovë

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

DHE PASQYRAT FINANCIARE PËR

VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2021

PËRMBAJTJA

Raporti i auditorit të pavarur

Pasqyra e pozitës financiare

3

Pasqyra e surplusit ose deficitit të fondeve

4

Pasqyra e ndryshimeve në fonde

5

Pasqyra e rrjedhës së parasë

6

Shënime mbi pasqyrat financiare

7-37

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Bordin e Drejtorëve dhe Menaxhmentin e Finca Kosovë

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Finca Kosovë (“Organizata”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021, dhe pasqyrën e surplusit ose deficit të fondeve dhe të ardhurave tjera gjithpërfshirëse, pasqyrën e fondeve, pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, si dhe shënimet mbi pasqyrat financiare përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat e bashkangjitura financiare të Organizatës janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me nenin 102, të ligjit nr. 04/L-093, të datës 11 maj 2012, “Ligji mbi bankat, institucionet mikrofinanciare, dhe institucionet financiare jo-bankare” sipas përshkrimit në shënimin 2 të pasqyrave financiare, dhe rregullave dhe rregulloreve të Bankës Qendore të Republikës së Kosovës.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona nën këto standarde janë përshkruar më tej në pjesën e “Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me kërkesat etike të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë që evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e duhur për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për kontrollat e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë anomali materiale, nga mashtrimi apo dhe gabimet.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Organizatës për parimin e vijueshmërisë, duke shpalosur, nëse e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e biznesit dhe duke përdorur parimin e vijueshmërisë së biznesit, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë Kompaninë ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë mënyrë.

Të ngarkuarit me qeverisje janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, dhe të lëshojmë një raport të auditorëve që përfshin mendimin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA do të zbulojë gjithmonë një keqdeklarim material kur ekziston. Anomalitë mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, mund të pritet në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që u përgjigjen atyre rreziqeve, dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një gabimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë bashkëpunim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm i cili është i rëndësishëm për auditimin në mënyrë që të dizajnohen procedura të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim mbi përshtatshmërinë e produktit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të dëshmive të auditimit të siguruara, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë së Organizatës. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit tonë për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në dëshmitë e auditimit të siguruara deri në datën e raportit të auditorit tonë. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerjen e parimit të vijimësisë së Organizatës.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në një mënyrë që arrin paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat që janë të ngarkuar me qeverisjen e Organizatës, në mes të tjerash, fushën e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Deloitte Kosova sh.p.k.
Deloitte Kosova sh.p.k.
Rr. Ukshin Hoti,
Prishtinë, Republika e Kosovës
Numri unik identifikues.: 810468373
30 mars 2022





Arta Limani
Arta Limani
Partnere e angazhimit

FINCA Kosovo
Pasqyra e pozitës financiare
Më 31 dhjetor 2021

	Shënime	Më 31 dhjetor 2021 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2020 (në EUR)
PASURITË			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	6	2,322,779	4,859,161
Depozitat me afat	7	-	1,500,717
Huatë ndaj klientëve	8	53,031,077	45,654,239
Parapagimet dhe pasuritë tjera	9	540,969	167,117
Pasuritë e paprekshme	10	3,809	6,853
Prona dhe pajisjet	11	424,152	435,786
E drejta e përdorimit të pasurisë	12	1,529,547	1,686,915
Gjithsej pasuritë		57,852,333	54,310,788
DETYRIMET			
Kreditë	13	34,461,407	34,600,695
Detyrimet tjera	14	924,592	828,340
Detyrimet e qirasë	12	1,639,925	1,758,487
Gjithsej detyrimet		37,025,924	37,187,522
Kapitali			
Kapitali i dhuruar	15	4,656,887	4,656,887
Surplusi i bartur		16,169,522	12,466,379
Gjithsej kapitali		20,826,409	17,123,266
Gjithsej detyrimet dhe kapitali		57,852,333	54,310,788

Autorizuar për lëshim nga menaxhmenti i FINCA Kosovo më 30 mars 2021, dhe nënshkruar në emër të tyre nga:


Ardian Kastrati
Drejtor Ekzekutiv


Endrit Duraku
Drejtor Financiar

Shënimet shoqëruese nga 7 deri 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FINCA Kosovë

Pasqyra e surplusit ose deficitit të fondeve dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse

Më dhe për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021

	Shënime	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021 (në EUR)	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 (në EUR)
Të hyrat nga interesi	16	10,631,585	10,150,828
Shpenzimet e interesit	16	(1,783,881)	(1,948,483)
Të hyrat neto nga interesi		8,847,704	8,202,345
Shpenzimet e zhvlerësimit të kredive	8	(398,624)	(944,238)
Të ardhurat neto nga interesi pas ndryshimeve të zhvlerësimit të kredisë		8,449,080	7,258,107
Të hyra të tjera operative	17	695,362	452,914
Shpenzimet për personelin	18	(3,176,302)	(2,429,078)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	19	(1,942,662)	(1,859,562)
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	10,11,12	(439,221)	(378,714)
Humbja nga transaksionet në kurset e këmbimit	20	(14,412)	(9,942)
Të hyrat neto të tjera jo-operative	21	131,299	19,235
Surplusi për vitin		3,703,144	3,052,960
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		3,703,144	3,052,960

Shënimet shoqëruese nga 7 deri 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FINCA Kosovë**Pasqyra e ndryshimeve në fonde**

Më dhe për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021

	Kapitali i dhuruar (në EUR)	Surplusi i mbajtur (në EUR)	Gjithsej (në EUR)
Gjendja më 1 janar 2020	4,656,887	9,413,418	14,070,305
Surplusi neto për vitin	-	3,052,960	3,052,960
Gjendja më 31 dhjetor 2020	4,656,887	12,466,378	17,123,265
Surplusi neto për vitin	-	3,703,144	3,703,144
Gjendja më 31 dhjetor 2021	4,656,887	16,169,522	20,826,409

Shënimet shoqëruese nga 7 deri 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

FINCA Kosovë
Pasqyra e rrjedhës së parasë

Më dhe për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021

Shënime	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2021 (në EUR)	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2020 (në EUR)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Surplusi i vitit	3,703,144	3,052,960
<i>Rregullimet për:</i>		
Zhvlerësim dhe amortizim	10,11,12 439,221	378,714
Humbjet nga rënia në vlerë e huave	8 847,119	944,238
Të hyrat nga interesi	16 (10,631,585)	(10,150,828)
Shpenzimet e interesit	16 1,783,881	1,948,483
Të hyrat tjera neto jo-operative	(131,298)	(19,235)
Humbja/(fitimi) nga kurset e këmbimit	(14,412)	(9,942)
	(4,003,930)	(3,835,726)
Rritja/(Zvogëlimi) i huave për klientët	8 (7,232,505)	1,342,703
Zvogëlimi/(Rritja) në parapagime dhe pasuritë tjera	373,851	(90,541)
Rritja në të hyrat e shtyra	8 (38,412)	(28,960)
Rritja/(Zvogëlimi) në detyrimet tjera	14 96,252	(122,657)
Interesi i pranuar	10,596,544	10,181,073
Interesi i paguar	(1,816,403)	(1,922,913)
Paraja neto nga aktivitetet operative	(2,024,603)	5,522,979
Rrjedha e parasë nga aktiviteti investuese		
Rritja e depozitave me afat	7 -	(1,500,000)
Blerja e pronës dhe pajisjeve/të drejtës së përdorimit të pasurive	11,12 (154,239)	(713,023)
Blerja e pasurive të paprekshme	10 (3,465)	-
Paraja neto nga aktivitetet investuese	(157,704)	(2,213,023)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financiare		
Kreditë e paguara tek huadhënësit	13 21,000,000	-
Kreditë e marra nga huadhënësit	13 (21,106,765)	(1,500,000)
Detyrimet ndaj qirasë	(247,310)	
Rrjedha e parasë e përdorur nga aktivitetet financiare	(354,075)	(1,500,000)
Zvogëlimi neto në para dhe ekuivalentë e parasë	(2,536,382)	1,809,956
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit.	4,859,161	3,049,205
Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e parasë në fund të vitit	6 2,322,779	4,859,161

Shënimet shoqëruese nga 7 deri 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.